

PASHKË TË GËZUARA!



NGJALLJA

Nr. 4 (195) Viti XVIII i botimit

PRILL 2009

Çmimi 20 lekë



Ikonë "Ngjallja", Onufri shek. XVI

"Është gjithmonë Pashkë!"

Është gjithmonë Pashkë, cilatdo qofshin rrethanat e jetës apo historisë sonë. Perëndia erdhi mes nesh, mbajti gëzimet, dëshpërimet tona, që gëzimet tona të mos mbërrin në iluzion, por në Mbretëri, që hidhërimet tona të mos na çojnë në hiç, por në Mbretëri. Dhe Mbretëria është Jeta, "Drita e Jetës", ashtu siç thoshte shën Joani. Pashkën mund ta kremtojmë në gëzim duke u shpërndarë fëmijëve vezë apo ëmbëlsira, mund ta kremtojmë Pashkën në dëshpërim, në tortura dhe në bomba, sepse rrënja e së keqes - vdekja - u shkul me anë të Ngjalljes; kështu vdekja biologjike dhe të gjitha llojet e vdekjeve të pjesshme që e paraprijnë të parën nuk janë veçse "kalime" drejt ngjalljes, pasi vdekja shpirtërore që i përmbledh dhe që ato simbolizojnë është shkatërruar njëherë e përgjithmonë.

Që sot e tutje, gjithçka ka një kuptim, një kuptim të përjetshëm. Jeta, Fryma, burojnë sot më shumë se kurrë nga vetë ankthet dhe neveritë tona. Thellë në revoltën tonë, në indignatën apo dëshpërimin tonë, nuk ekziston më hiç, por i Kryqëzuar i Lavdëruar. Perëndia nuk është i fuqishëm në kuptimin e fuqive kozmike dhe sociale, si p.sh. tiranët dhe uraganet, ai vepron si një rrezatim, një derdhje jete, kuraje, besimi, lirie. Ai e lë veten të kryqëzohet mbi të keqen e botës, "Krishti është në agoni deri në fund të botës", ka thënë Paskali, ndërsa shën Maksim Konfessori thotë: "Perëndia u bë i varfër për shkak të përkujdesjes së tij ndaj nesh, duke vuajtur mistikisht nga dhembshuria e tij deri në fundin e kohëve, sipas masës së vuajtjes së secilit". Por ky i Kryqëzuar

(vijon në faqen 6)



Kisha e Kryeengjellit Mihail në Vithkuq, Korçë. Ajo është monument kulture i klasit të parë dhe është ndërtuar në vitin 1682.


Pikturimi i saj është bërë në vitin 1728 dhe dallohet veçanërisht për afresket e mrekullueshme, të cilat kanë ardhur deri në ditët e sotme në gjendje shumë të mirë.



Libra të rinj**JAVA E MADHE
E SHENJTË**

Në këtë botim janë shfrytëzuar gjerësisht përkthimet dhe përshtatjet në gjuhën shqipe të Imzot Theofan Nolit, në dy variantet e botuara: “Triodi i Vogël”, Boston, 1913; “Triodi dhe Pesëdhjetorja”, Boston, 1952; “Pesëdhjetore e Vogël”, Boston, 1914. Ndërsa Shërbesat e Mbrëmësore dhe të Mëngjesore, të cilat u morën nga “Libër i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse”, botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë, 1994, janë vendosur të plota në pjesën e dytë të këtij libri. Gjithashtu, po nga ky libër, janë marrë edhe një pjesë e psalmeve dhe vargjeve psalmike të aliluarëve dhe të leximeve biblike, ndërkohë që psalmet e tjera janë marrë dhe përshtatur në gjuhën e sotme nga përkthimi në shqip i tyre prej Konstandin Kristoforidhit “Psaltiri”, Konstandinopol, 1868.

Leximet nga Dhiata e Re janë marrë nga botimi “Dhiata e Re”, përshtatur në gjuhën e sotme shqipe prej përkthimit të Konstandin Kristoforidhit, botuar nga Shoqëria Biblike Ndërkonfesionale e Shqipërisë për Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë, 2005. Ndërsa leximet nga Dhiata e Vjetër, të cilat janë botuar në një shtojcë të veçantë që shoqëron këtë libër, janë marrë nga “Bibla”,



versioni Diodati i Ri, përkthimi 1991-94, botim i Shoqatës Shqiptare Biblike (ABS), Tiranë, 1994.

Për tipikonë e shërbesave dhe plotësimet e nevojshme ndihmëse, është përdorur si model botimi në greqisht: “Java e Madhe dhe e Shenjtë”, Athinë, 1999. Në botimin shqip, ndryshe nga ai në greqisht, nuk janë vendosur Shërbesat e Orëve të çdo dite, Pasdarka e Madhe, që kryhet tri ditët e para të Javës së Madhe, si dhe Pasdarka e Vogël.

Shpeshtohen vjedhjet e kishave në zonën e Korçës

Më 31 mars, natën, kisha e Shën Thanasit në Korçë, është bërë shënjestra e radhës, ku persona ende të paidentifikuar kanë hyrë brenda, duke thyer kasafortën dhe marrë paratë e hedhura nga besimtarët.

Policia nisi hetimet, por ende nuk ka ndonjë të ndaluar për këtë veprim të shëmtuar. Kanë qenë përfaqësuesit e Mitropolisë së Shenjtë të Korçës, që kanë sinjalizuar policinë për këtë vjedhje dhe kanë kërkuar kapjen e autorëve, pasi ky është një rast i përsëritur që cenon objektet e kultit orthodhoks, jo vetëm në qytet, por dhe në zonat e tjera të qarkut.

Policia deklaroi se ishte në gjurmët e autorëve, por vetëm 4 ditë më pas u thye po gjatë natës dhe u vodhën paratë e besimtarëve edhe kisha e Hyjlindës në fshatin Mborje, rreth 3 km larg qytetit të Korçës.

Gjithashtu, në janar ishte vjedhur për të disatën herë kisha e Trinisë së Shenjtë, në varrezat e Korçës.

Të gjitha këto vjedhje iu shtohen atyre të vitit të kaluar apo viteve të mëparshme, kur deklarohet se po hetohen “të dyshuar”, por asnjëherë nuk kapen autorët.

Letër falënderimi në redaksi***E falënderojmë dhe i jemi mirënjohës...***

Ne që po shkruajmë jemi banorë orthodhoksë të fshatit Grabovë e Sipërme, komuna Lenie, rrethi Gramsh. Ashtu si dhe shumë arumunë në mbarë Shqipërinë e më tej kemi një histori të veçantë për sa i përket besimit tonë të krishterë orthodhoks. Këtë besim ne e kemi ruajtur me shumë fanatizëm ndër shekuj. Dëshmi për

këtë jemi vetë sot. Në qoftë se pushtimi turk arriti të nënshtrojë dhe t’u kthejë besimin pjesës më të madhe, ne nuk e pranuan këtë gjë dhe vajtëm të banonim në majat më të larta, ku jeta përballej me vështirësi nga më të mëdhatë.

Mirëpo gjithë kësaj sakrifice të madhe për të ruajtur besimin, sistemi komunist për 50 vjet u

përpoq t’i hedhë baltë e ta shkatërrojë derisa Perëndia bëri të mundur ardhjen e demokracisë në këtë vend. Perëndia na solli edhe Fortlumturinë e Tij, Kryepiskopin Anastas, i cili hodhi themelet e Ringjalljes së besimit shpirtëror në Shqipëri, si dhe të rindërtimit të Kishës Orthodhokse në mbarë vendin, deri në skajin më të largët. Dëshmi për këtë punë të madhe që ka bërë ky njeri jemi dhe ne banorët orthodhoksë të Grabovës, ku Kryepiskopi restauroi 2 kishat e vjetra, atë të Shën Parashqevisë (1703) dhe shpëtoi përfundimisht kishën e Shën Kollit, një nga objektet më të rëndësishme të kulturës Orthodhokse dhe të artit mesjetar shqiptar, e rindërtuar në vitin 1803

mbi themelet e një kisha akoma më të vjetër bizantine, me një sipërfaqe ndërtimi afro 600 m², ku gjëja më e veçantë e saj ishte tavani i kësaj kisha ku kishin piktura piktorët e famshëm grabovarë vëllezërit Çetiri.

Ja pra përse e falënderojmë nga thellësia e zemrës prof. dr. Anastasin. E falënderojmë për punën e madhe dhe të pazëvendësueshme që ai ka bërë dhe bën në Shqipëri. Për këtë ne orthodhoksët e Grabovës i jemi shumë mirënjohës dhe jo vetëm ne, po gjithë populli shqiptar.

Zoti e bekoftë atë.

*Me shumë respekt,
nga orthodhoksët
e Grabovës.*

Për më tepër informacion rreth

**KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALË
TË SHQIPËRISË**

vizitoni faqen tonë të internetit

www.orthodoxalbania.org

ose na kontaktoni në

orthchal@orthodoxalbania.org

Titull Nderi për Kryepiskopin Anastas
në Universitetin "Demokriti" të Thrakës

“... DASHURIA E MUND FRIKËN”

Me një ceremoni të ngrohtë stafi akademik dhe studentët e Universitetit "Demokriti" të Thrakës, nderuan Kryepiskopin e Tiranës, Durrësit dhe të gjithë Shqipërisë, Anastasin, me rastin e akordimit të titullit "Doktor Nderi" i këtij Universiteti. Ceremonia e dorëzimit të titullit u zhvillua të hënën, 31 mars 2009, pasdite, në amfiteatrin qendror të Universitetit, në Komotini. Kryepiskopin e shoqëronte Mitropoliti i Gjirokastrës, Hirësia e Tij Dhimitri.

Salla e universitetit, ishte mbushur si asnjëherë. Në ceremoni merrnin pjesë profesorati, studentët, gazetarë, intelektualë të gjithë zonës së Thrakës etj.

Për të nderuar Kryepiskopin Anastas kishin ardhur Mitropolitët e Komotinisë Dhamaskino, i Ksanthit, i Aleksandropolit, i Kavallës, i Nevrokopit, autoritetet shtetërore e lokale, Myftiu i Komotinisë etj.

Ceremoninë e hapi Rektori i Universitetit "Demokriti" të Thrakës, z. Konstandinos Simopoulos, Profesor i Kirurgjisë, i cili foli me një respekt të thellë dhe mirënjohje të botës intelektuale për punën dhe veprën e Kryepiskopit Anastas. Rektori tha veç të tjerash se, kjo mënyrë jetese dhe pune me vetë-sakrificim të paiterës, frymëzohet kryesisht nga dashuria për Perëndinë dhe për njeriun. "Në një kohë kur rreth nesh vihen në dyshim vlerat dhe zhvlerësimi i figurave është një fenomen i rëndomtë, Kryepiskopi Anastas përbën përjashtimin pozitiv.", theksoi ai ndër të tjera.

Një atmosferë të veçantë përcolli edhe leximi i mesazhit të dër-

guar me këtë rast nga Patriarku Ekumenik, Tërëshenjtëria e Tij Vartholomeu I, të cilin e përfaqësonte Mitropoliti i Komotinisë.

Vendimin e Departamentit të Historisë dhe Etnologjisë, si edhe atij të Gjuhëve, Filologjisë dhe Kulturës së Popujve të Detit të Zi, e komunikoi Kryetari i këtij të fundit, Profesor i së Drejtës Penale, z. Stefanos Pavllos. Mes të tjerash theksoi se nga ky vendim i departamenteve të tyre për nderimin e Kryepiskopit Anastas "Doktor Nderi" dhe pranimit prej tij, nderon vetë Universitetin tonë. Me respekt të veçantë z. Pavllos iu referua jetës së Kryepiskopit, respektit që ai tregon për çdo figurë njeriu dhe më gjerë. Ky është direkt mësimi më i vyer për pedagogët dhe studentët tanë, të cilët pikërisht e kanë objekt të studimeve dhe punës së tyre kërkimore. Këtu veçohet shembulli që Kryepiskopi ka treguar në krye të Kishës në Shqipëri, duke kontribuar për bashkëjetesën ndër-fetare dhe paqtimin e Ballkanit.

Për jetën dhe veprën e Kryepiskopit Anastas foli Profesi i Pa-

leografisë, Kryetar i Departamentit të Historisë dhe Etnologjisë, z. Jorgo Papazoglou. I gjithë publiku u njoh me një dëshmi të gjallë të vlerave të njeriut që i është dhënë tërësisht Krishtit. Kudo ku Kryepiskopi punoi, në Afrikë, në Greqi dhe veçanërisht në Shqipëri, në Kishë apo në auditorët e Universiteteve, kudo manifestoi vlera të veçanta, origjinalitet, dashuri të pakufishme.

Gjatë veprimtarisë u shfaq për të pranishmit një dokumentar i shkurtër filmik nga vepra e jashtëzakonshme e ringjalljes së besimit Orthodhoks në Shqipëri.

Pas aktit të dorëzimit zyrtar të dekoratës dhe leximit të vendimit të dy departamenteve, e mori fjalën Kryepiskopi Anastas. Ai mbajti ligjëratën me temë: "Terrorizmi dhe

frika - Korelacione religjioze". Bëhet fjalë për një kumtesë aq aktuale, ku ligjëruesi befasoi edhe një herë publikun me nivel të lartë të prani-shëm në sallë, me informacionin e gjerë të zhvillimeve në këtë fushë.

Për qëndrimin e Kishës Orthodhokse mbi këto çështje Kryepiskopi Anastas theksoi se kemi detyrim nga besimi ynë që të duam pa asnjë ekuivok çdo krijesë njerëzore, të respektojmë çdo person apo komunitet, pavarësisht nëse beson dhe në çfarë beson. "Frikën e mundim me Dashuri", ishte përfundimi i fjalës së Fortlumturisë së Tij.

Kryepiskopi kreu edhe vizita vëllazërore në mitropolitë e Komotinisë, të Ksanthit dhe Aleksandropolit.

Korresp. i "NGJALLJA",
Komotini, 31 mars 2009



Godina qendrore e Universitetit "Demokriti" në Komotini.

Feja nuk është alibi për gjakderdhje

Fjalë prekëse e Kryepiskopit të Tiranës me rastin e shpalljes së tij "Doktor Nderi" i Universitetit "Demokriti"

*Nga Stavro Xhima,
gazeta "Kathimerini"*

Kur në mes të vitit 1998 kriza nacionaliste e Jugosllavisë shkaktoi luftë në Kosovë, me rrezik shtrirjen e zjarrit në Ballkanin Juglindor dhe disa qarqe të caktuara u përpoqën t'i japin karakter fetar konfliktit, ai nuk ngurroi të lartësojë zërin e tij.

"Askush nuk ka të drejtën të përdorë vajin e shenjtë të fesë që të fuqizojë zjarrin e konflikteve të armatosura. Feja është dhuratë hyjnore për të zbutur zemrat, për të shëruar plagët dhe për t'i afruar njerëzit në paqe. Ata që e implikojnë me dhunën dhunojnë thelbësisht frymën e saj". Sikundër ka ndodhur edhe me luftërat e tjera në të shkuarën në rajonin tonë, kështu edhe tani kur frika e terrorizmit mbarëbotëror, që ka karakteristika të dallueshme fetare, shtrihet nga

një cep i planetit në tjetrin, Kryepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë nuk rresht së shpalluri tek të gjithë se "Duhet t'i bëjmë rezistencë përdorimit të fesë për konflikte të armatosura, si dhe mbështetjes së terrorizmit nga ana e saj".

Terrorizëm dhe frikë

E nënvizoi këtë gjë edhe në darkën e së hënës në Komotini, një qytet ku bashkëjetojnë të krishterë dhe myslimanë, gjatë ceremonisë së shpalljes së tij "Doktor Nderi", nga Departamenti i Jurisprudencës i Universitetit "Demokriti", duke folur përballë një audience

(vijon në faqen 4)

Feja nuk është alibi për gjakderdhje

(vijon nga faqja 3)

të gjerë, midis të cilëve edhe myftiu i Komotinisë, zoti Menxho Xhemali, me temë “Terrorizmi dhe frika - korrelacione religjioze”. Zoti Anastas tha se “argumentet e Bin Ladenit për sulme në Perëndim, ngjajnë shumë me retorikën fetare të Papës Urbani II, kur më 27 nëntor 1095 predikoi në Kishën Katedrale të Klermontit në Francë për të nxitur të krishterët e Perëndimit për Kryqëzatën e parë” dhe pasi vuri re se “vepra si për shembull vetëvrasja, kamikazët etj., të cilat në Perëndim i quajnë akte terroriste, janë për mijëra myslimanë vepra heroike, pranim i sakrificës për mbrojtjen e Islamit”

...
“Liderët fetarë dhe politikë të Evropës duhet t’i kushtojnë një vëmendje më të madhe ndjenjës së fortë që mbizotëron në botën islamike, se ajo po pëson padrejtësi nga bota perëndimore dhe se duhen ndërmarrë lëvizje që ta korrigjojnë këtë. Por në të njëjtën kohë duhet që të nxjerrim në pah edhe padrejtësitë që bëhen nga regjime myslimane në dëm të minoriteteve të krishtera.”

Kryepiskopi i Shqipërisë, duke vazhduar fjalën e tij, tha se myslimanët në Evropë ndihen se bëhen viktimë të dyfishta, nga njëra anë e terrorizmit dhe nga ana tjetër e masave shtrënguese.

“Detyra e të gjithë liderëve fetarë është përpjekja e vazhdueshme dhe e ndërgjegjshme, me fjalë dhe me vepra për mposhtjen e çdo

forme të dhunës, përpjekja e duruar për pajtim në vendin ku ne jetojmë dhe më gjerë në rajonin tonë, interesimi për lirinë e të gjithë minoriteteve të feve të ndryshme në Evropë, Azi dhe në Afrikë zhvillimi i një sistemi fetar arsimor të qëndrueshëm.

Në shumë rajone, si në Lindjen e Mesme, në Ballkan ekziston një rrezatim i fortë dyshimi, hidhësie dhe urrejtjeje. Ky është kërcënimi më i rrezikshëm për paqen dhe bashkekzistencën harmonike, dhe që të përballohet në mënyrë thelbësore, do të nevojiten fuqi shpirtërore, të cilat do të fuqizojnë faljen, pajtimin dhe dashurinë me anë të një dialogu jete”, theksoi ai në një pikë tjetër.

Fjala filozofike

Fjalë theologjike që është filozofike e thellë, fjalë pajtimi që dëgjohej e paqtë, por edhe e mprehtë në mes të një salle të mbushur plot, si dhe përballë ekranit gjigant ku paraqiteshin skena (nga aventura ballkanike) e këtij Hierarku të guximshëm: plane me shpjegime të tij në kisha të shkatërruara, liturgji në mbetjet e manastireve orthodhokse të rrënuara etj.

Jetë e mbushur plot me përpjekje

Një përafrim për një problem shumë akut të epokës sonë nën prizmin e dimensioneve mbarënjerezore dhe universale të dashurisë së krishterë “të cilën nuk mund ta përmbajë asnjë gardh, etnik apo fetar”, nga një klerik që e mësoi këtë në xhunglat e Afrikës dhe që përpiket, në

kushte të vështira, ta hedhë themele në një vend si Shqipëria, ku kishte qenë varrosur për më tepër se një gjysmë shekulli nga sistemi diktatorial ateist i Hoxhës.

Pikëpamje të një udhëheqësi fetar, një personaliteti fetar me rrezatim mbarëbotëror, që është aktiv në një shoqëri ku myslimanë, katolikë dhe orthodhoksë përpiqen përditë për përhapjen e parimeve të dogmave të tyre pa kundërvënien të ashpra dhe përplasje të rrezikshme, duke gjetur modus vivendi -n e tyre...

Traditë popullore

Ditën e Premte para Pashkës së Madhe dilnin fëmijët nëpër fshat e mblidhnin dru e në një kodër të fshatit bënin një stivë të madhe në krye të së cilës vendosnin një kafkë kafshe që simbolizonte vdekjen. Këtë stivë e ndiznin natën e Pashkës së Madhe kur thuhej “Krishti u Ngjall”.

Mbledhim dru për stivën

Për stivën e madhe,

Se po na vjen Pashka

Pashka jonë e madhe.

Pashka me ve të kuqe,

Të gjithë të çukasin

Edhe të thërrasin:

Krishti ynë u ngjall

Pashkët gëzuar.



Më 22 mars, Falja e Kryqit u kremtua me madhësi nga të gjithë besimtarët orthodhoksë, të cilët morën dhe çuan në shtëpitë e tyre lulet që simbolizojnë jetën e re që çel nëpërmjet kryqit të Zotit.

Jerusalem

Mrekullia e Dritës së Shenjtë të Pashkës

Kjo mrekulli ndodh çdo vit në Kishën e Ngjalljes së Zotit në Jerusalem, vetëm gjatë të kremtes së Pashkës së Madhe orthodhoksë. Flaka e Shenjtë e kësaj drite është mrekullia më e njohur e të krishterëve orthodhoksë dhe del vetëm pasi lutet një patriark orthodhoks. Nuk ka asnjë mrekulli tjetër në botë që ndodh me kaq përpikmëri dhe gjithnjë në një kohë të caktuar, kur patriarku futet në varrin e Zotit Jisu Krisht për të shpallur Ngjalljen e Tij. Kjo Kishë ndodhet në vendin ku Krishti u kryqëzua, u varros dhe ku u ngjall të tretën ditë.

Besimtarët e shumtë orthodhoksë që vijnë nga e gjithë bota, qëndrojnë në pritje nga e Premja e Madhe për t'u bërë dëshmitarë të mrekullisë që ndodh të Shtunën e Madhe. Gjatë kësaj dite të krishterët arabë këndojnë himne tradicionale me zë të lartë. Këto himne datojnë në shekullin e 13-të, kur të krishterët nuk lejoheshin të këndonin në ndonjë vend tjetër, përveçse në kishat e tyre. Himnet thonë: "Ne jemi të krishterë, kemi qenë të krishterë dhe do të jemi të krishterë". Pas kësaj nisin të bien daullet dhe pas tyre bëhet një heshtje e madhe.

Në këtë pikë vjen një delegacion i qeveritarëve lokalë izraelitë, funksioni i të cilëve është të përfaqësojnë romakët e kohës së Krishtit. Këta njësoj si ushtarët romakë, e vulosin me dyllë varrin e shenjtë ku do të hyjë patriarku orthodhoks dhe para kësaj kontrollojnë se mos ketë ndonjë burim zjarri të fshehur.

Si ndodh mrekullia

"Unë hyj në varr dhe bie në gjunjë në vendin ku Krishti u vendos pasi vdiq dhe u ngjall përsëri së vdekurish - ka treguar patriarku i ndjerë Diodori në rrëfimet e tij. - "Them disa lutje që na janë dhënë t'i përdorim ndër shekuj dhe pasi i kam thënë, qëndroj në pritje. Disa herë pres pak minuta, por zakonisht, mrekullia ndodh menjëherë, pasi kam thënë lutjet. Nga e çara e gurit mbi të cilin ishte shtrirë



Krishti, del drita. Zakonisht ka një ngjyrë blu, por ngjyra mund të ndryshojë e të marrë ngjyrime të ndryshme. Drita del nga guri si një

mjegull që ngrihet sipër një liqeniduket sikur guri është mbuluar nga një re e dendur, por kjo është dritë. Drita sillet çdo vit në mënyra të

Edhe Maria rrinte pranë varrit duke qarë përjashta. Dhe tek po qante, u ul në varr. Edhe vë re dy engjëj me rroba të bardha duke ndenjuri njëri nga kreu e tjetri nga këmbët, atje ku qe trupi i Jisuit. Edhe ata i thonë asaj: Grua, pse qan? U thotë atyre: Sepse ngritën tim Zot, dhe nuk di ku e kanë vënë. Edhe si tha këto, u kthye prapa, dhe vë re Jisuin duke ndenjuri, dhe nuk e dinte se është Jisui. Jisui i tha asaj: Grua, pse qan? Cilin kërkon? Po ajo duke pandehur se është kopshtari, i thotë: Zot, në e ngrite ti, thuajmë ku e ke vënë, dhe unë do ta ngre atë. Jisui i thotë asaj: Maria! Ajo kthehet e i thotë: Rabuni! që domethënë Mësues. Jisui i thotë asaj: Mos m'u mbështet; sepse ende s'jam ngjitur tek Ati im; po shko tek vëllezërit e mi, dhe u thuaj atyre: Po ngjitem tek Ati im edhe tek Ati juaj, dhe tek Perëndia im dhe tek Perëndia juaj. Vjen Maria Magdalena dhe lajmëron nxënësit se pa Zotin, dhe se i tha asaj këto fjalë.

Joani 20:11-18

ndryshme. Disa herë mbulon vetëm gurin, kurse herë të tjera e mbulon të gjithë varrin e besimtarët përjashta e shikojnë atë të mbushur me dritë. Flaka nuk djeg, kurrë nuk më ka djegur ndonjë herë mjekrën gjatë gjithë viteve që kam qenë patriark i Jerusalem dhe kam marrë Zjarrin e Shenjtë. Drita e Shenjtë ka një konsistencë tjetër nga ajo që digjet në një llambë me vaj... Në një moment të caktuar, drita ngjitet lart dhe formon një kolonë në të cilën zjarri ka një natyrë tjetër. Kështu unë mundem të ndez qiri tek kjo kolonë. Kur unë kam marrë flakën për qirinjtë e mi, dal jashtë dhe ia jap së pari patriarkut armen dhe pastaj atij kopt. Pastaj unë ua jap flakën të gjithë njerëzve që ndodhen në Kishë".

Drita e Shenjtë nuk shpërndahet vetëm nga patriarku, por vepron edhe vetë. Del nga Varri i Shenjtë me një dritë tjetër nga ajo e dritës natyrale. Shkon sa nga njëra anë në tjetrën. Ka edhe pelegrinë shpërsëtarë të cilëve iu ndizen vetë qirinjtë nga kjo dritë e shenjtë. Është një flakë e kaltër dhe nuk djeg në momentet e para nëse të prek fytyrën, flokët ose duart. Kjo mrekulli daton nga shekulli i parë, kur apostulli Petro e pa Dritën e Shenjtë në Varrin e Zotit. Në disa raste, klerikë jo orthodhoksë janë përpjekur të marrin këtë Dritë të Shenjtë, por kanë dështuar dhe janë përballur me dënimin e Perëndisë. Në vitin 1579 ndodhi edhe një mrekulli që e bëri të qartë se vetëm orthodhoksëve iu jepej kjo e drejtë. Armenët kishin paguar turqit që kishin pushtuar tokën e shenjtë, që të mos i lejonin orthodhoksët të afroreshin pranë Varrit të Shenjtë në ditën e Pashkës. Patriarku Orthodhoks qëndroi larg hyrjes bashkë me grigjën e tij afër një kolone për të bërë celebrimin në atë vend dhe Drita e Shenjtë zbriti aty duke e çarë kolonën më dysh siç mund të shikohet qartë edhe sot. Një muezin që këndonte aty afër, e pa mrekullinë dhe u bë i krishterë orthodhoks, e si rrjedhojë e këtij akti u martirizua.

Përgatiti T. Bendo

“Është gjithmonë Pashkë!”

(vijon nga faqja 1)

Është tani një i Ngjallur, ai jepet tek ne, edhe tek ata që e mohojnë.

Që nga Pashka, është gjithmonë Pashkë, kuptimi, jeta na vijnë gjithashtu nga vdekja dhe nga të gjitha situatat e vdekjes gjatë ekzistencës sonë dhe të historisë, nëse nga një besim i përlurur, një besim tek nata, ne i identifikojmë ato me plagët e gjalla të Krishtit.

Malraux, pak para vdekjes së tij thoshte: “Pres profetin që do të guxojë t’i thërrasë botës: nuk ka hiç!” Secili prej nesh është thirrur të bëhet, ndonjëherë, pak, për një çast, ky profet. Pasi Ngjallja është bërë një e fshehtë, që pak e kanë kurajën ta komunikojnë, se kaq shumë na dërrmon spektakli i dhimbjeve.

Si ta komunikojmë Ngjalljen - duke hyrë në këtë dhembshuri të pamasë, në këtë dashuri pa


kufi, e vetmja që na shpjegon Mishërimin, Pasionin, Kryqin si fitoren e fundit mbi vdekjen. Vetëm njerëzit e dhembshur, me dashuri të gjallë dhe në të njëjtën kohë që mbahen fort nga lutja, mirënjohja, kremtimi, mund të kuptojnë se në fund të gjërave nuk ka absurditet, por kuptim. Nuk ka hiç, por dashuri më të fuqishme se vdekja.

“Në bregun tjetër”

“Kur të vdes, shkruan shën Serafimi i Sarovit, ejani në varrin tim, ejani shpesh atje. M’i thoni të gjitha dhe unë do t’ju dëgjoj. Çdo trishtim do të largohet nga ju... Më flisni ashtu sikundër bënit më parë, sepse jam i gjallë dhe do të jem kështu përgjithmonë”.

Ky eremit rus (1759-1833), i cili jetonte bashkë me kafshët e egra, është një nga njerëzit shpirtërorë më të mëdhenj, që janë tërësisht “kungim”. Prandaj edhe ai mund ta thotë këtë. Nga ky fakt besoj se ne duhet t’u besojmë gjëra njerëzve të ndierë të cilët kanë arritur një shkallë të tillë universalitetit. E kam këtu fjalën për njerëzit që dëshmojnë që këtu në tokë se nuk jemi të ndarë nga asnjë njeri, se njerëzimi formon, *in fine*, një njeri të vetëm, sepse ajo do të jetë tërësisht e mbledhur dhe e shpërfytyruar më Krishtin, sipas shprehjes së Nicolas de Cuses, në “njeriun maksimal” në të cilin të gjithë ne jemi një. Atë që thotë shën Serafimi i Sarovit më bëjnë të mendoj banorët e ishullit të Egjinës (Greqi). Ata dëshirojnë fort të shkojnë në varrin e shën Nektarit, sepse siç thotë vetë ata, kur e vënë veshin mbi gurin e varrit, dëgjojnë zemrën e shenjtit të rrahë. Njoh edhe një murg të Malit të Shenjtë, njeri i thellë, i cili ka atë shpirtëror shën Isak Sirianin, shenjt i shekullit të 7-të. Ai ka me të një lidhje të thellë, të hollësishme dhe reale. Kjo i çudit mendjet tona karteziane, por besimi na drejton të besojmë se ka gjendje ndërjegjeje, gjendje shpirtërore të shumëllojshme. Ky besim nuk është objekt i një doktrine të fiksuar të Kishës, por është një temë shumë e pranishme dhe e dashur për Etërit.

Të krishterët orthodoksë flasin për Jerusalemin qiellor ose Mbretërinë e Perëndisë. Parajsa, ishte në fillin, para rënies. Ndërsa Mbretëria e Perëndisë e përmbledh Historinë. Mbretëria qiellore do të jetë gjithashtu një përmbushje e gjithçkaje të mirë e të bukur, që



njerëzit kanë krijuar gjatë kohëve. Ashtu siç thotë edhe shën Joani në Apokalips, “gjithë kombet do të sjellin nderin e tyre dhe lavdinë e tyre në Jerusalemin qiellor”. Parajsa, është një kopsht, ndërsa Jerusalemi qiellor, është një qytet, për të cilin shën Joani na thotë se muret do të jenë të ndërtuara me gurët e çmuar më të trashë dhe më transparentë. Ngjallje e përgjithshme, Gjykim i fundit, Jerusalemi qiellor: këto shprehje provojnë të shprehin një realitet që i shpëton të kuptuarit tonë. Sipas mësuesit Eckhart, ne do të jetojmë në një gjendje të “bashkëshkrirjes pa përzierje”. Është po aq mistike sa Trinia, për të cilën teologët thonë se ajo paraqet në të njëjtën kohë bashkimin më absolut dhe ndarjen më rrënjësore. Është ajo çka në besim, në lutje dhe së fundi, në soditjen e mistereve hyjnore, ne mund ta kuptojmë menjëherë.

Gjithçka do të jetë e shpërfytyruar, si mendja jonë, ashtu edhe trupi ynë. Sa për trupin, mund të kemi një parafigurim në atë që ungjillorët thonë për shfaqjet e Jisuit, mes ngjalljes dhe ngjitjes së Tij në qiell. Në disa çaste, Ai është i

pranishëm në shumë vende në të njëjtën kohë. Prania e Tij e mishëruar dhe gjithashtu e shpërfytyruar, zbulon një kohë dhe një hapësirë ndryshe nga e jona. Ndonjëherë, në momente të një gëzimi të madh dhe mbushullie, kemi një parashijim të kësaj gjendjeje ku nuk do të ketë as vdekje dhe as ndarje. Në këtë mendim, Léo Zander, mik i afërt i teologut bashkëkohor rus Sergej Bulgakov, më ka thënë një ditë: “Në Mbretërinë e Perëndisë, do të mund të vazhdojmë të dëgjojmë muzikën e Bahut dhe të Moxartit, por nuk do të ketë ikona, sepse të gjithë ne do të jemi ikona”.

Por si mund të jemi të lidhur me njerëzit që kanë ikur nga kjo jetë?

Në Eukaristinë Hyjnore! Pasi Trupi i Krishtit i bashkon të gjallët dhe të fjeturit. Sa më shumë hyjmë në Eukaristi, aq më shumë hyjmë në Trupin e Krishtit, dhe gjithnjë e më pak jemi të ndarë nga njëri-tjetri, të gjallë apo të vdekur.

Pleqëria i është dhënë njeriut që ai të paqësohet dhe të përpiqet të tejkalojë gjithë urrejtjet, ashpërsitë që ka akumuluar gjatë jetës. Dhe të kthehet në një fëmijë. D.m.th. si dikush që jeton në çast, që nuk projektet për të ardhmen, por jeton me besim në pritjen e fundit.

Për mua, afrimi i vdekjes nuk është as shkurajuese dhe as dërrmuese. Besoj thellësisht se do të pritemi që të gjithë nga Krishti i ngjallur. E di se Ai më pret, se do të jetë atje. Kam një besim të madh. Në Liturgjinë Hyjnore, ne kërkojmë hir për të pasur një vdekje të paqme, nëse është e mundur të rrethuar nga të tjtë. Një legjendë e Lindjes së Mesme thotë se kur dikush do të vdesë, Perëndia i dërgon engjëllin e vdekjes që t’i marrë shpirtin. Ky engjëll ka krahë të mbuluar me shumë palë sy. Ndonjëherë Perëndia ndryshon mendim. E thërret engjëllin, i cili duke u nisur, shkëput një palë sy dhe ia jep atij që, i kthyer nga vdekja, shikon tani gjithçka me këta sy. Ky shikim transparent a nuk është ajo çka duhet të kërkojmë që tani?

Nga Olivier Clément
Përktheu Eleni Pani

Kontributi i Kishës dhe i Kryepiskopit Anastas për edukimin dhe arsimimin**“Shtëpia Orthodhokse e Shpresës”**

Me bekimin dhe fondet e siguruara nga Fortlumturia e Tij Kryepiskopi Anastas, në verën e vitit 2003 filloi funksionimin si një shtëpi-familje “Shtëpia Orthodhokse e Shpresës”, pranë mjediseve të Akademisë Theologjike “Ngjallja e Krishtit”, në Manastirin e Shën Vlashit, Durrës.

Veprimtaria e saj nisi vetëm me tetë fëmijë, por shumë shpejt ky numër arriti deri në 30, që është edhe kapaciteti maksimal i shtëpisë.

Të gjithë fëmijët, mosha e të cilëve shkon nga 5-18 vjeç, vijnë nga familje me vështirësi ekonomike ose fatkeqësi familjare, por edhe nga familje ku mungon një nga prindërit biologjikë. Nevojat tyre janë të shumta, por më tepër se çdo gjë tjetër ata kanë nevojë për dashuri të paku-



shtëzuar të njerëzve që i rrethojnë, kanë nevojë të ndihen të sigurt dhe të vlerësuar, të barabartë mes moshatarëve dhe të respektuar nga të tjerët. Të gjitha këto kanë qenë në fokusin e punës 4 vjeçare të stafit të kësaj shtëpie-familjeje.

Aktualisht në të jetojnë 28 fëmijë, 19 vajza dhe 9 djem dhe të gjithë shkojnë në shkollë. Ata frekuentojnë nga klasa e 2-të fillore deri në vitin e 2-të të shkollës së mesme.

Kjo shtëpi ofron për të gjithë fëmijët:

- Arsimit dhe edukim sa më të mirë
- Mbështetje psiko-sociale
- Ushqim, veshmbathje, shërbim mjekësor sipas standardeve
- Një jetë komode e të sigurt si në familje
- Veprimtari sportive, zbavitëse dhe formuese brenda kohës së lirë
- Stimulimin e marrëdhënieve të mira me prindërit dhe të afërmit

Me rritjen e fëmijëve është rritur edhe përgjegjësia e punës dhe kujdesi nga ana e stafit. Gjithashtu, gjatë viteve ka ndryshuar edhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të kësaj qendre. Stafi është i impenjuar jo vetëm në plotësimin e kushteve materiale dhe ofrimit të një jete të qetë dhe komode, por është i përqendruar

edhe në zhvillimin kompleks të fëmijëve, duke i mbështetur hap pas hapi për një rritje sa më të shëndetshme:

Nga ana mësimore - edukative: Fëmijët ndihmohen nga mësues privatë dhe edukatorët për arritjen e rezultateve sa më të mira në mësim. Është parë e domosdoshme për të pasur mbështetje të vazhdueshme, pasi një pjesë e tyre kur erdhën nga familjet e origjinës kishin mangësi të thella në njohuritë e përgjithshme. Disa fëmijë kanë qenë tërësisht analfabetë edhe në moshën shkollore. Kjo për shkak të arsyeve të ndryshme si: mosfrekuentimi i rregullt i shkollës, mungesa e interesit të familjarëve për ecurinë e tyre, pamundësia për vazhdimin e shkollës për arsye të ndryshme etj.

Sot, ata ndjekin rregullisht shkollën sipas klasave përkatëse dhe me rezultate të kënaqshme. Disa prej tyre janë edhe nxënës të shkëlqyer në klasat dhe shkollat ku mësojnë.

Nga ana fiziko - shëndetësore: Shëndeti i fëmijëve është në qendër të vëmendjes. Për të përmbushur sa më mirë këtë qëllim, një pjesë të veçantë në veprimtaritë e ditës e zënë aktivitetet sportive, argëtuese dhe çlodhëse. Gjithashtu, të gjithë fëmijëve u bëhen rregullisht vizita të ndryshme mjekësore etj.

Nga ana emocionale: Fëmijët janë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmohen përmes trajtimeve psiko-sociale për kalimin e traumave të përjetuara në familjet e tyre, përmes nxitjes së vlerësimit të vetvetes dhe mundësive për përmirësim të vazhdueshëm në jetë.

Ndryshimet që vërehen te këta fëmijë janë shumë domethënëse. Nga fëmijë me probleme të theksuara emocionale, agresivë ose shumë të ndrojtur, të paafte për të zotëruar aftësi thelbësore sociale, me sjellje antisociale dhe vetëshkatërruese etj., sot janë fëmijë dhe adoleshentë të shoqërueshëm, me mendime të qarta, që nuk ngurrojnë t'i shprehin hapur. Kanë

dëshirat e tyre dhe janë integruar mirë në shoqëri, duke ecur me hapat e kohës si të gjithë bashkëmoshatarët e tyre.

Një tjetër qëllim i “Shtëpisë Orthodhokse të Shpresës” është edhe përgatitja dhe krijimi i kushteve për rikthimin e këtyre fëmijëve (kur ekziston mundësia) në familjet e tyre biologjike. Në përputhje edhe me ligjet në fuqi të shtetit për këto raste, bëhet një punë shumë e madhe



nga ana e stafit për mbështetjen e familjeve të fëmijëve për të mundësuar përmirësimin e kushteve në to dhe krijimin e një mjedisi familjar të sigurt dhe të qëndrueshëm, që do të mundësojë edhe rikthimin e fëmijëve në një të ardhme të afërt.

“Shtëpia Orthodhokse e Shpresës” kujdeset për ecurinë e fëmijëve jo vetëm brenda mjediseve të saj. Ky kujdes vazhdon edhe pasi ata largohen nga qendra, duke u interesuar për mirëqenien dhe shkollimin e tyre, siç është rasti i dy fëmijëve të rikthyer në familjen biologjike gjatë vitit të kaluar dhe rasti tjetër, i një vajze e cila është tashmë maturante me rezultate mjaft të mira dhe banon në një nga konviktet e Kishës sonë.

Në “Shtëpinë Orthodhokse të Shpresës” fëmijët rriten si individë unikë, duke iu respektuar të gjitha të drejtat dhe nevojat e tyre, si materiale dhe shpirtërore, gjithmonë me qëllimin e vetëm, që të jenë një forcë dhe zë i rëndësishëm i shoqërisë shqiptare.



Ky Ungjill na përshkruan dy personazhe tragjikë: Personazhi i parë jetoi një lumturi absolute, në luks, me veshje të kushtueshme, në bankete madhështore, por pas vdekjes pa një fatkeqësi pa fund, u gjend i rrethuar nga flakët e ferrit nga ku kërkon pa reshtur që t'i dërgojnë pak freskim për ta çliruar. Nga ana tjetër, shikojmë personazhin e dytë, një njeri që jetoi në varfëri absolute gjatë gjithë jetës, duke pritur në derën e këtij të pasuri për t'i dhënë ndonjë thërrime buke që binin nga tavolina. Është i mbuluar me plagë dhe qentë vinin e ia lëpinin. Edhe ky vdiq, u çua nga engjëjt në gji të Abrahamit, në lumturinë e përjetshme. Kjo histori tronditëse ka shumë për të na mësuar.

Fillimisht vërejmë se në këtë pjesë të Ungjillit nuk zihet në gojë emri i të pasurit. Ai nuk ka emër, ndërsa i varfri quhet Llazar. Kjo ka një kuptim të veçantë, pasi emri na jep identitetin tonë. Është ai që tregon se jemi një njeri i veçantë dhe që kemi personin tonë. Një njeri pa emër është si ai të mos ekzistojë fare. Nuk e zgjedhim vetë emrin, na është dhënë nga të tjerët. Kjo nënkupton se që të ekzistojmë, që të kemi një emër, duhet të jemi në marrëdhënie me të tjerët. Kur izolohehi bëhemi të panjohur, anonimë, në mosqenie, nuk jemi. I pasuri i Ungjillit ishte anonim, sepse nuk i përkushtohej njeriu tjetër përveç vetes së tij, mirëqenies së tij, dhe kështu mbetet pa emër. Nga ana tjetër Llazar i varfër ka një emër domethënës që në hebraisht do të thotë "Përendia më ndihmoi", sepse askush nuk e thërriste me emrin e tij dhe nuk e donte. E përçmonin totalisht, por me gjithë këtë ai ka personin e tij dhe jeton, dhe këtë e ka nga marrëdhënia me Perëndinë, në duart e të Cilit ka besuar jetën dhe gjithë shpirtin. Njëra anë e kësaj bote qëndron anonime për Perëndinë, ndërsa tjetra ka një hipostazë, një emër që dëshmon se jeton përjetësisht.

Pika e dytë e Ungjillit, e cila duhet nënvizuar është situata në të cilën ndodhet i pasuri, pra në ferr dhe kërkon ndihmën e dikujt, pikërisht të Llazarit (të atij që përçmonte) që t'i sillte pak ujë për t'i freskuar gjuhën me majën e gishtit. I përgjigjen se është e pamundur, sepse ka një largësi të madhe mes

I pasuri dhe lypësi Llazar

Omeli mbi Ungjillin e Llukait 16,19-31

ferrit dhe parajsës e kjo humnerë është e pakapërcyeshme. Përse gjithë kjo humnerë? Por kjo ekziston tashmë që në jetën tokësore. Sigurisht, në jetën tonë ne e përcaktojmë të ardhmen për përjetësinë. Nëse në këtë jetë ka një humnerë mes nesh dhe njerëzve, kjo do të na ndjekë edhe në përjetësi. Ferri i përjetshëm është zgjatja e kësaj humnerë që jetuam mbi tokë, parajsja është zgjatja e një jete në të cilën nuk pati humnerë mes njerëzve, kur dashuria i bashkon ata dhe nuk ka largësi.

Një tjetër pikë e rëndësishme e këtij Ungjilli është se askush nuk mund ta përmbysë këtë humnerë. Situata në të cilën gjendet i pasuri dhe i varfri mbetet e njëjta për përjetësinë dhe nuk mund të ndryshojë. Po përse? Duket se i pasuri i cili vuan në ferr, pendohet për jetën e tij, megjithatë ky pendim nuk mund ta shpëtojë, sepse tashmë nuk ka më trup, kohë, fuqi siç i kishte kur ishte në tokë për t'u korrigjuar. Pendimi nuk është real pa një drejtim, ndreqje. Nuk mund të korrigjohemi pa pasur trupin tonë, kohën dhe të

gjitha ato që Perëndia jep në jetën këtu që të pendohemi dhe të rregullojmë gabimet tona. Vetëm në këtë jetë kemi mundësi të pendohemi.

Në urtësinë e Etërve të shkretëtirës gjejmë një histori të shën Makar egjiptianit tepër domethënës për rastin tonë. Thuhet se shën Makari duke ecur në shkretëtirë gjeti një kafkë, e lëvizi me shkopin e tij dhe e pyeti: "Kush je ti?" Kafka iu përgjigj: "Jam një prift idhujtar dhe gjendem në ferr, por ti je Makari, apo jo? Sepse ti lutesh dhe kjo vepron dhe ndihemi pak të çliruar." Shën Makari i kërkoi: "Si është ferri juaj dhe si e ndieni çlirimin?" Ai iu përgjigj: "Në ferrin tonë, të gjithë jemi të lidhur dhe fytyra jonë është e ngjitur mbi shpatullën e dikujt tjetër që është para nesh. Askush nuk mund të shikojë fytyrën e tjetrit. Por kur ju luteni për ne mund të shikojmë fytyrën e tjetrit." Atëherë shën Makari e lëvizi kafkën dhe tha: "Fatkeqë dita që u lind ky njeri!"

Ky ferr është vërtet i tmerrshëm, d.m.th. mos mundësh dot të shikosh as fytyrën e tjetrit. Këtë

jetë që fatkeqësisht e zgjedhim shpesh duke e larguar tjetrin me qëllim që të jemi vetë, ky largim, kjo humnerë që krijojmë në marrëdhëniet tona me të tjerët, ky është ferri, ferri i përjetshëm, pasi nëse është mënyra jonë e jetesës në këtë botë, kjo mënyrë do të na ndjekë edhe në përjetësi. Le të vigjilojmë për të ndërtuar një urë mbi të gjitha këto humnera që kemi në jetë mes nesh dhe të tjerëve dhe sidomos me armiqtë. Nëse nuk arrijmë të ndërtojmë një urë mes nesh dhe armikut, kjo do të na ndjekë edhe në përjetësi e kjo do përbëjë ferrin tonë.

Mesazhi i këtij Ungjilli le të na ruajë me të vërtetë nga një situatë e tillë. Le të kemi kujdes me humnerat që ekzistojnë në jetën tonë, me ndarjet, përplasjet etj. Le të shërohem menjëherë, sepse kurrë nuk e dimë sa do jemi në këtë botë dhe sa kohë do kemi për të rivendosur me ta marrëdhënien e parë dhe të vendosim ashtu si Llazar, qenien dhe përjetësinë tonë në duart e Perëndisë; atëherë, mëshira e Tij do të jetë me ne.

*Nga peshkopi i Pergamit
Joan (Ziziulas)*

Mbi kujdesin për shpëtimin e vëllezërve tanë

"Askush të mos kërkojë interesin e tij personal, por secili le të kërkojë atë të vëllait të tij" (I Kor.10, 24)

Ja parimi i shenjtorëve të Perëndisë, ai i kohëve të shkuara dhe i kohës së tashme, i çdo kohe e deri në fund të botës. Ja parimi i çdo strukture të vërtetë sociale.

Mbi këtë parim mund të themelojmë një shoqëri njerëzore, e cila do të jetë më e përkryera, më e lumtura dhe ajo që do t'i pëlqejë Perëndisë.

Me të gjitha llojet e vështirësive që njerëzit ndeshen në ditët tona, kundër të cilave luftojnë pa fitore e pa shpresë, ky parim është shpëtimtar. Shpirti i bekuar shqetësohet për të afërmin e tij, për atë që është në krah të tij dhe për atë që është larg tij. Ai shqetësohet se ku do të kalojë natën i pastrehu, me çfarë do të ushqehet, çfarë do të veshë ai që është zhveshur. Shqetësohet për shpëtimin e fqinjëve të tij dhe lutet për këtë; që zemrat e tyre të mbushen me dashuri për Perëndinë, që fryma e tyre të drejtohet drejt Tij, që neglizhentët t'i kthejnë kurrizin së keqes, që dyshuesit të forcohen në besë, që të fortët të këmbëngulin edhe më shumë, që të fjeturit të mund të shikojnë Fytyrën e Perëndisë, që të gjallët të shkruhen në Librin e Jetës, në Mbretërinë e Dritës.

Por kujdes, shikoni se si mund të jetë edhe parimi i djallit, i cili shkatërron dhe copëton. Ta dini se djalli nuk do që askush të vigjilojë mbi trupin e tij, ta ruajë të pastër atë nga mëkati, por më tepër të shikojë trupin e tjetrit, ta shkatërrojë e ta përlyejë; ai do që askush të mos ekzaminojë shpirtin e tij që të shpëtojë, por më shumë të tjetrit, për ta njollosur atë, të shpifë kundër tij, ta varfërojë dhe ta rrënojë; askush të mos kujdeset për shtëpinë e tij, për ta ndërtuar e rinovuar, por kërkon, që ta djegë e shembë; askush të mos kujdeset për hambarët e tij se si t'i mbushë, por shikon që t'i vjedhë e boshatisë.

Ja pra se si ky parim mund të jetë në të njëjtën kohë i mirë dhe i keq, një shpatë e mprehtë me dy presa, engjëllore dhe djallëzore. Ja se si ky parim, në frymën dhe në formën e tij satanike ka gjetur shprehjen e tij sot kudo, në çdo anë të botës.

O Zot, Shpirti i Shenjtë, që i dërgove këto fjalë të shenjta në botë nëpërmjet gojës së apostujve të Perëndisë si rreze dielli për të na ndriçuar pa na djegur, na ndihmo t'i përmbushim këto fjalë në kuptimin e tyre të vërtetë e qiellor, për lavdi të Perëndisë Triadik dhe për shpëtimin e shpirtave tanë.

Ty të përket lavdërimi dhe lavdia përherë. Amin.

Omeli nga shën Nikolla Velimiroviç

Takim i Patriarkut Ekumenik Vartholomeu I me Presidentin e SHBA Barak Obama

Tërëshnjtëria e Tij, Patriarku Ekumenik Vartholomeu I pati një takim privat me Presidentin Barak Obama. Takimi u zhvillua në Hotelin "Conrad" në Konstandinopojë. Në këtë takim ishin të pranishëm Hirësia e Tij, Kryepiskopi Dhimitër i Amerikës dhe shefi i stafit të Shtëpisë së Bardhë, Rahm Emanuel.

Takimi u zhvillua në një frymë përzemërsie dhe respekti të ndërsjellë. Thelbi i bisedimeve përfshiu pjesën e fjalimit të Presidentit Obama që mbajti në parlamentin e Turqisë, në lidhje me çështjen e Fakultetit Theologjik të Halkit, si dhe diskutimin për këtë çështje me Presidentin e vendit, Abdullah Gul.

Presidenti u shpreh se ai do të ndjekë zhvillimin e kësaj çështjeje për një zgjidhje, e cila do të kënaqë Patriarkanën Ekumenike.

Tërëshnjtëria e Tij, Patriarku Ekumenik

Vartholomeu I në bisedën e Tij, iu referua pikave të mëposhtme:

1. Ai argumentoi nevojën e ngutshme për hapjen e Fakultetit Theologjik të Halkit, ku do të formohen, edukohen dhe do të përgatiten klerikët e Patriarkanës Ekumenike.

2. Ai theksoi rëndësinë e lirisë fetare dhe garantimin e saj për të gjitha minoritetet në Turqi.

3. Ai i deklaroi presidentit mbështetjen e tij

të njohur për përpjekjet e Turqisë që të hyjë në Bashkimin Evropian.

4. Bëri të ditur rëndësinë e përpjekjeve të bëra nga ana e tij në lidhje me ambientin dhe Simpoziumin e ardhshëm të Ekologjisë në Misisipi SHBA në tetor 2009.

5. E falënderoi Presidentin Obama për këtë takim dhe për interesin e tij aktiv në problemet e mprehta të Patriarkanës Ekumenike.

Gjithashtu Tërëshnjtëria e Tij i bëri të ditur se i kishte dërguar Presidentit Obama, nëpërmjet konsullatës së SHBA një ikonë të Profetit Baruk, emrin e të cilit mban edhe z. Obama me një përkushtim të shkruar nga dora e tij.

RADIO "NGJALLJA", NË FM 88.5 MHz.

Ajo transmeton për ju 24 orë program.

Do të dëgjoni gjithçka që ju duhet: programe shpirtërore, sociale dhe kulturore. Muzikë e zgjedhur kishtare, popullore dhe klasike, nga vendi dhe bota.

Ndiqni shërbesat kishtare në Radio "Ngjallja"!

"Një dhuratë nga fëmija, për fëmijën!"

Një projekt ndihmash për më të vegjlit i zbatuar nga Zyra Diakonia Agapes - Shërbimi i Dashurisë, e Kishës sonë

"Dhurata të fëmijëve për fëmijën" është ndër projektet e zbatuara nga zyra Diakonia Agapes, e cila është zyra sociale, zhvilluese dhe e emergjencës e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Ky projekt ka filluar që në vitin 2007 dhe mbështetet nga Fondacioni Edukans- Holandë. Me anë të kësaj nisme, për fëmijë të ndryshëm në të gjithë vendin shpërndahen dhurata simbolike. E veçanta e shpërndarjes është se çdo dhuratë përgatitet nga një fëmijë holandez dhe i dedikohet një fëmije shqiptar.

Përgjatë viteve të zbatimit, zyra Diakonia Agapes ka bërë përzgjedhjen e fëmijëve përfitues duke synuar fëmijët të cilët jetojnë në zona të thella malore, fëmijë të varfër, jetimë dhe kryesisht të shtresave sociale në nevojë.

Për këto shpërndarje ajo ka pasur bashkëpunimin e drejtorive arsimore në rrethet Librazhd, Gramsh, Elbasan, Kavajë, koordinimin me

Kryepiskopatën e Hirshme dhe Mitropolinë e Korçës, për identifikimin dhe kryerjen e shpërndarjes në Tiranë dhe Korçë si dhe në bashkëpunim me organizata të ndryshme të cilat ofrojnë shërbime për fëmijë në nevojë.

Deri në muajin mars 2009, janë shpërndarë rreth 10600 paketa ndihme, nga të cilat rreth 9150 për fëmijët e 52 shkollave e kopshteve

të qarkut të Elbasanit, 507 në dioqezën e Korçës, 400 pako u shpërndanë për fëmijët të cilët marrin pjesë në aktivitetet e kryera nga Zyra Kombëtare e Fëmijëve e Kishës Orthodhokse Autoqefale Shqipërisë, si dhe rreth 540 pako të tjera për fëmijët e përkujdesjeve ditore të Kishës.

Stafi që është marrë me zbatimin e projektit në zonë shprehet

se edhe pse shpesh duhet një udhëtim i gjatë për të mbërritur në shkollat malore të Librazhdit apo Gramshit, ndihesh vërtet shumë mirë kur sheh fytyrat e qeshura të fëmijëve, të cilët i gëzohen dhuratës simbolike por me aq shumë vlerë për ta! Në zonë na mirëpresin gjithmonë edukatorë, prindër e mësues. Ata, ashtu si edhe fëmijët e dinë se më shumë se sa dhurata për të gjithë ka rëndësi më shumë vlerësimi që iu bëhet duke i vizituar aty, në komunitetet e tyre.

Nga kjo kupton se nisma të tilla nuk duhet të reshtin asnjëherë. Nga sytë e tyre kupton se njerëzit kanë në radhë të parë nevojë të duan njëri-tjetrin dhe të dinë si ta shprehin këtë dashuri, qoftë edhe me gjeste të vogla përkujdesjeje. E mbi të gjitha nga kjo kupton se edukimi për dashuri e paqe vjen duke edukuar së pari brezin e fëmijëve, të cilët janë e ardhmja e njerëzimit.

O. Th.



Nga Shenjtorët e muajit

Athanas meteoriti (20 Prill)

Androniku, siç e kishte emrin e pagëzimit, lindi në Ipati, në Lamia të Greqisë (1305) nga prindër të pasur dhe të njohur, që vdiqën para kohe. Pra u rrit nga xhaxhai dhe studioi Shkrimet e Shenjta. Sapo katalanasit pushtuan vendlindjen e tij (1319), u kap rob, por u arratis, gjeti xhaxhain dhe lundruan drejt Selanikut, ku ai vdiq. Shenjti, duke qenë i pashëm, i zgjuar dhe arsimdashës, por i varfër, tërhoqi vëmendjen e mësuesve, të cilët e mësuan falas. Iku në Malin e Shenjtë, por nuk e mbajtën atje, sepse ishte ende shumë i ri, pa mjekër. Në Konstandinopolje frekuentoi pranë shën Grigor Sinaetit (6 prill) dhe të tjerëve. Në ishullin e Kretës u mikprit prej një besimtari, por shkoi përsëri në Athos (1335), sepse mori vesh se ai e mendonte se ishte i përshtatshëm të martohej me vajzën e tij. Sipas një këshille të shën Kalistit (20 qershor) u bë bindës i hieromonakut Grigor Politi dhe e monakut Moisi. U qeth murg nga Grigori me emrin Andon fillimisht dhe më vonë Athanas, dhe mori përsipër të gjitha punët, që kryheshin jashtë, e vëllazërisë në mal, me gjithë rreziqet e shpeshta nga dëborat. Meqenëse sulmoheshin nga piratët, Grigori dhe oshënari ynë shkuan në Selanik, në Veria dhe në Meteorën e sotme. Atje banuan në kishën e ngritur mbi shkëmbin "Stilo" (=shtylla).

Kur jeronti u lodh dhe donte të zbriste, nxënësi i tij e inkurajoi. Dhe vërtet, njerëzit e morën vesh, shumë vinin e u sillnin gjëra të nevojshme. U krijua një vëllazëri, por Athanasi, që i pëlqente qetësia, tërhoqi në izolim dhe vetëm të dielën vinte në Liturgji. U luftua nga demonët dhe në fund u vendos në një shkëmb të madh, të cilit i dha emrin "Meteor". Kur pas dhjetë vjetësh qëndrimi në Meteorë Grigori po largohej përfundimisht, shenjti e arriti në Selanik, por sipas porosisë së tij ai (Athanasi) u kthye përsëri. Meqë u mblodhën mjaft vëllazër, ndërtoi Manastirin e Metamorfozës. Arkimandriti (igumeni) parashikuesi dhe çudibërësi si para ashtu edhe pas fjetjes së tij (1383) kishte si nxënës Shën Joasafin.

Joasaf meteoriti (20 Prill)

Ishte bindësi i oshënarit pararendës, Athanasit dhe bashkëndërtuesi i Manastirit të famshëm, Meteorit të Madh. Kur më 1371 mirëbërësi i Meteorëve "Simeoni Urësi Paleologi, perandori i romakëve dhe serbëve dhe i çdo shqiptari" vdiq në kryeqytetin e tij Trikalla, në Thesali, pasardhësi i tij, mik i murgjërësë, Joan Urësi Angjeli Komnini, Duka Paleologi, u kthye nga Mali i Shenjtë ku ishte, që të kurorëzohej si mbret. Përshkoi Meteorët dhe u njoh me igumenin e dëgjuar dhe organizatorin Athanas, udhëzues i pafjetur i shpirtrave. Manastiri prej shumë anëtarësh i avat rrezatonte si far, madje rrezatonte më shumë pas kthimit të tij nga manastiri "idhiorrithmë" (d.m.th. ku çdo murg ka veç arkën, mensën etj.) siç e kishte krijuar fillimisht, në manastir qinoviak dhe kishte



shkruar rregulloren e tij të çmuar. Joani kreu një akt që nderoi manastirin edhe më shumë. Shkëmbu kurorën mbretërore me "kukulin" (mbulesë monakale e kokës), d.m.th. u qeth murg, pasi vendosi si

mbret të Epirit - Therralisë një të afërm të tij. Riparoi dhe zgjeroi kishën e Metamorfozës (1378-1388), e cila brenda dy shekujve të mëparshëm u pikturua përsëri në mënyrë të mahnitshme me afreske që ekzistojnë edhe sot. Në punët ndërtimore të kishës, ndihmoi me kërkesë të tij edhe e motra, Agjelina, mbretëresha e Janinës, e cila përveç kësaj i dhuroi enë dhe bagëti. Shembullin e oshënarëve të shumëlidhur, Athanasit dhe Joasafit, që futën në Meteorë jetën monakale qinoviake, e ndoqën dhe murgj të tjerë atje, të cilët u mblodhën në qinovi gjithashtu. Kafkat e shumërespektuara të dy shenjtorëve ruhen në manastirin e tyre të mrekullueshëm.

Atë *Justini*

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, MAJ 2009

2 E Shtunë † Sh. Athanasi i Madh. Dësh. Esperit, Zoia.

3 E Diel † E MIROPRURËSEVE. Dësh. Timotheu e Maura.

5 E Martë † Dëshmg. Irini. Eftimi i Madhitës. Dësh. Gajani e Gai.

8 E Premte † * Ap. e Ungjillor Joan Theologu. Osh. Arseni i Madh.

9 E Shtunë † Pr. Isaia. Dësh. Kristofori, Kalinika e Akilina.

10 E Diel † E TË PARALIZUARIT. Ap. Simeon Zelloti. Osh. Laurenti.

11 E hënë † Qirili e Metodi, ndriçues të sllavëve. Hierod. Moku.

13 E Mërkurë † # Gjysmëpentikostia. Dëshg. Gliqeria. Omol. Sergji.

15 E Premte * Osh. Pahomi i Madh. Akili i Larisës. Barbar mirovliti.

16 E Shtunë † Osh. Theodhori i Shenjtëruar. Dësh. i ri Nikolla.

17 E Diel † E SAMARITANES. Ap. Androniku e Junia nga të 70^t.

21 E Enjte † Konstandini dhe Elena, mbretër. Borisi, mbreti bullgar.

22 E Premte † Dësh. Vasiliski. Sin. II Ekum. Joan Vladimiri. (Fest. më 4 qershor.)

23 E Shtunë † Miroprurëse Maria e Kleopës. Mihaili i Sinadës.

24 E Diel † E TË VERBRIT. Osh. Simeoni e Nikita. Dësh. Kristiani.

25 E Hënë † Gjetja III e kokës së Joan Pagëzorit. Dësh. Celestini.

27 E Mërkurë † # Mbyllja e Pashkës. Hierod. Heladhi. Omol. Joan rusi.

28 E Enjte † Ngjitja në qiej e Zotit Krisht (Analipsi). Hierod. Eftihi.

30 E Shtunë † Osh. Isaaku i Dalmatëve. Dësh. Natali. Shën Emelia.


31 E Diel † E ETËRVE SIN. I EK. Petronila, bija e Ap. Petros. Dësh. Ermia.

Paris**Ekspozitë me thesaret e Malit të Shenjtë**

Në muzeun e Petiti Palais, në Paris, nga data 10 prill deri më 5 qershor, është hapur një ekspozitë e jashtëzakonshme kushtuar thesareve të artit bizantin, me origjinë nga manastiret e Malit të Shenjtë. Ato janë krijuar midis shekujve IX dhe XVIII, dhe në ekspozitë mund të shihen manuskripte të shkëlqyera, ikona, objekte liturgjike relikuare, afreske, rroba, mozaikë, krisobulla te perandorëve dhe zyrtarëve të lartë bizantinë apo të mbretërve orthodhoksë sllavë, rumunë etj.

Këto thesare kanë dalë vetëm një herë nga Mali i Shenjtë, për ekspozitën e artit bizantin në Selanik, në vitin 1997.

Gjithashtu, do të ekspozohen edhe ikonat e koleksionit të Petit Palais, me vlerë të jashtëzakonshme dhe më i pasuri në Francë.

Qipro**Kisha çon shtetin turk në Gjyqin Evropian për të drejtat e njeriut**

Që nga viti 1974, kur ushtria turke okupoi pjesën veriore të ishullit, ka pasur një shkatërrim dhe dëmtim sistematik të objekteve dhe pasurive të Kishës Orthodhokse. Ndaj, sipas agjencive të lajmeve, Kryepiskopi Krisostomi II ka marrë nismën për ta çuar problemin përpara Gjyqit Evropian për të drejtat e njeriut, në Strasburg, për dhunim të nenit të parë të konventës evropiane për të

drejtat e njeriut (mbrojtje e pasurisë) dhe 9 (e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit).

Turqia akuzohet se ka mbyllur 522 vende kulti, kisha apo manastire, një pjesë e të cilave janë shkatërruar plotësisht dhe të tjerë janë kthyer në xhami (78 kisha), garazhe, klube nate, morgje, hotele, kazerma ushtarake etj. Gjë e cila vazhdon të ndodhë edhe sot.

Madrid**Do jepet truall për një katedrale orthodhokse**

Kryetari i Bashkisë së Madridit njoftoi në mars, gjatë një ceremonie simbolike të dorëzimit të çelësave të qytetit Presidentit rus Medvedev, se shpejt Bashkia do t'i japë një terren Patriarkanës së Moskës, për ndërtimin e një katedraleje orthodhokse në kryeqytetin spanjoll.

Fakte nga Ungjilli

Kur u kryqëzua Jisui? Sipas studimeve të kryera, Perandoria romake është themeluar rreth vitit 753 para Krishtit. Me kalendarin e vjetër përkon viti 1. Në vitin 767 ka ardhur në pushtet Tiber çezari, d.m.th. 767-753=14+15 vitet e mbretërimit të tij = 29, kur u shfaq Shën Joan Pagëzori. 29+1 (vit predikimi) =30. 30+3 (vite të predikimit të Zotit, sipas Ungjillit të Joanit) përfundimisht = 33. Jisu Krishti u kryqëzua në moshën 33-vjeçare.

Vdekjen e Krishtit e shoqëruan 4 ngjarje të mrekullueshme: **1** - errësira, **2** - grisja më dysh e perdes në Tempull, ndërkohë që tempulli kishte tri pjesë kryesore - sheshet ose oborret për të gjithë njerëzit, Vendin e Shenjtë (ku mund të hynin vetëm priftërinjtë) dhe Vendin më të Shenjtë (ku mund

të hynte vetëm kryepriifti, vetëm një herë në vit për të larë mëkatet e kombit). Pikërisht në vendin më të Shenjtë rrinte arka e besëlidhjes dhe prania e Perëndisë me të. **Perdja** që e ndante Vendin e Shenjtë nga Vendi më i Shenjtë u gris në dy pjesë duke simbolizuar heqjen e pengesës midis Perëndisë dhe njerëzimit; **3** - një tërmet dhe **4** - ngritja e njerëzve të vdekur nga varret.

A ju ka lindur ndonjë pyetje se përveç shprehjes "O Atë fali se.." çfarë mund të ketë thënë Zoti akoma në momentin kur gjendej në kryq? **Njihuni me 7 thëniet e fundit të Jisuit në kryq:** **1** - "O Atë, fali ata sepse nuk dinë ç'bëjnë" (Llk.23:34). **2** - "Sot do të jesh me mua në parajsë (Llk.23:43). **3** - Duke iu drejtuar Joanit dhe Marisë: "Ky është biri yt tani"!... "Ja nëna

jote" (Jn. 19:26-27). **4** - Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur"? (Mt. 27:46; Mk. 15:34). **5** - "Kam etje" (Jn. 19:28). **6** - "U krye" (Jn. 19:30). **7** - "O Atë, në duart e tua po e dorëzoh frymën time" (Llk.23:46). Këto thënie paraqesin si Njerishmërinë e Jisuit, ashtu edhe Hyjninë e Tij. Gjithashtu ato ngulitin çastet e fundit të gjithçkaje që Jisui përjetoi për të fituar faljen tonë.

Në procesin e vdekjes së Jisuit u ndryshuan 4 njerëz. **Krimineli** (kursari) që ishte duke vdekur në kryq pranë Jisuit, i cili i kërkoi ta merrte atë në mbretërinë e Tij (Llk.23:39-43). **Kapiteni romak** (centurioni) shpalli se sigurisht Jisui ishte Biri i Perëndisë (Mk.15:39). **Josifi dhe Nikodhimi**, anëtarë të Këshillit çifut dhe ndjekës të fshehtë të Jisuit (Jn.7:50-52).

Përgatiti Elena Krakulli



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin
e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:
Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë
Tel: (04) 2234 117, (04) 2235 095
Fax: (04) 2232 109
Shtypur
në shtypshkronjën "Ngjallja"

Të Dielat pas Pashkës

E Diela e Shën Thomait

E Diela pas Pashke, e quajtur e Diela e Dytë, është dita e fundit e Javës së Ndrishme.

Në shërbesat e Kishës i vihet theksi shfaqjes së Krishtit tek Apostulli Thoma. Rëndësia e ditës vjen tek ne nëpërmjet fjalëve të Ungjillit:

Pastaj i tha Thomait: “Vëre gishtin këtu dhe shiko duart e mia; dhe shtrije dorën e vëre në brinjën time; dhe mos u bëj i pabesë, por besëtar. Edhe Thomai u përgjigj e i tha “Zoti im dhe Perëndia im!” Jisui i thotë: “Sepse më pe besove, lum ata që nuk panë dhe besuan” (Jn. 20:27-29).

Ne nuk e kemi parë Krishtin me sytë fizikë dhe as e kemi prekur trupin e tij të ngjallur me duart tona, por në Shpirtin e Shenjtë ne e kemi parë dhe shijuar Fjalën e Jetës (I Jn. 1:1-4) dhe kështu ne besojmë.

Në çdo shërbesë ditore deri në Ditën e Ngjijtes, Analipsit, ne këndojmë Troparin e Pashkës. Në secilën nga shërbesat e të Dielave pas Pashke, duke filluar me të Dielën e Shën Thomait, këndojmë Kanonin dhe himnet e Pashkës dhe përsërisim kremtimin e “ditës së parë të javës”, në të cilën Krishti u ngjall së vdekurish.



E Diela e Miroprurëseve

E diela e tretë mbas Pashke i kushtohet grave miroprurëse, të cilat u kujdesën për trupin e Shpëtimtarit në vdekjen e Tij dhe ishin dëshmitaret e para të Ngjalljes së Tij. Të tre troparet e të Premtes së Madhe këndohen përsëri dhe formojnë temën e ditës:

Bujari Josif, pasi e zbriti trupin tënd prej Kryqit të Çmuar, e mbështolli me një savan të paqme, e leu me vajëra erëmirë dhe e vuri në një varr të ri.

Zbrite në vdekje dhe në varr për ne, ti o jetë e pavdekshme, Ferrin të vdekur e shtrive kur ndriçove si Perëndi.

Një engjëll u qëndroi para grave miroprurëse dhe iu tha: Miroja është e përshtatshme për të vdekurit, por Krishti e tregoi veten të çliruar nga prishja! Prandaj shpallni: Zoti u ngjall dhe i fal botës mëshirë e shpëtim.

E Diela e Ulokut

E Diela e katërt i kushtohet shërimit të ulokut prej Krishtit (Jn. 5). Ky njeri u shërua nga Krishti ndërsa po priste që dikush ta zbriste në pellgun e ujit. Nëpërmjet pagëzimit në Kishë, ne gjithashtu jemi shëruar dhe shpëtuar nga Krishti për jetën e amshuar. Kështu, kjo ngjarje na tregon se edhe ne së bashku me ulokun duhet që **“të mos mëkatojmë më që të mos na bëhet ndonjë gjë më e keqe” (Jn. 5:14).**

Gjysmëpentikostia

Në mes të javës së katërt, kremtohet solemnisht dita në mes të Pashkës dhe Pentikostisë, Rrëshajeve. Kjo quhet festa e **Gjysmëpentikostisë**, në të cilën Krishti “në mes të festës” i mëson njerëzit për misionin e tij shpëtimtar dhe i ofron të gjithëve **“ujin e gjallë” (Jn. 7:14, 38).** Përsëri ne kujtohem për praninë e Mësuesit dhe për premtimin e Tij shpëtimtar: **“Nëse dikush ka etje, le të vijë tek unë e të pijë” (Jn. 7:37).** Ne mendojmë përsëri për vdekjen dhe ngjalljen tonë me Krishtin në Pagëzimin tonë dhe për marrjen e Shpirtit të Shenjtë prej Tij në Mirosjen. Ne “shohim mbrapa njëri dhe paramarrim tjetri” siç thotë një nga himnet e festës. Ne e dimë që i përkasim mbretërisë së Krishtit të Ngjallur, ku **“Shpirti dhe Nusja thonë ‘Eja!’ Dhe ai që ka etje, le të vijë; dhe ai që do, le të marrë si dhuratë ujin e jetës” (Zbulesa 22:17, Isaia 55:1).**

Në mesin e festës, o Shpëtimtar, shuaje etjen e shpirtit tim me ujin e gjallë, siç i ke premtuar të gjithëve: Nëse dikush ka etje, le të vijë të pijë! O Krisht Perëndi, Burim i jetës, lavdi më Ty (Përlëshorja).

Krishti Perëndi, Krijuesi dhe Zoti i të gjithëve, i ftoi të gjithë në mes të festës: Ejani dhe pini ujin e pavdekësisë! Ne falemi para Teje dhe thërrasim plot besim: Falna mëshirat e tua, se Ti je Burimi i jetës sonë! (Shkurtorja).

E Diela e Samaritanes

E Diela e pestë flet për një grua nga Samaria, me të cilën Krishti foli në pusin e Jakovit (Jn. 4). Edhe këtu tema është për **“ujin e gjallë”** dhe njohjen e Jisuit si Mesia i Perëndisë



(Jn. 4:10-11; 25-26). Kjo na kujton për jetën tonë të re në atë, për pirjen tonë nga **“uji i gjallë”**, për adhurimin tonë të vërtetë të Perëndisë në kohën e krishterë mesianike, **“në Frymë dhe në të Vërtetë” (Jn. 4:23-24).** Ne shohim gjithashtu që shpëtimi i ofrohet të gjithëve: Judejve dhe Kombeve, burrave dhe grave, shenjtorëve dhe mëkatarëve.

E Diela e të Verbrit

E Diela e gjashtë përkuqton shërimin e një njeriu që kishte lindur i verbër (Jn. 9). Ne jemi të identifikuar me këtë njeri, i cili arriti të shohë dhe ta njohë Jisuin si Birin e Perëndisë. Zoti i ka lyer sytë tanë me dorën e tij hyjnore dhe i ka larë ato me ujin e pagëzimit (Jn. 9:6-11).

Jisui përdori baltë me pështymë dhe i tha të verbrit të shkonte e të lahej në pellgun e Siloamit. Ai e bëri këtë në ditën e Sabatit, ditë në të cilën, të pështyrët, baltëbërja dhe larja ishin të ndaluara. Duke i shkelur këto ligje rituale të Judejve, Jisui tregoi që Ai është me të vërtetë Zoti i Sabatit dhe, si i tillë, Ai është i barabartë me Perëndinë Atë, i Cili, sipas traditës Judaike, është i vetmi që punon në ditën e Sabatit, duke drejtuar botën e tij.

Patë një skandal në shërimin e të verbrit në ditën e Sabatit. Ai u nda nga sinagoga për shkak të besës së tij në Krishtin. E tërë Kisha e ndoqi këtë njeri në rrugën e saj, duke e ditur se ata që nuk e shohin Jisuin si Zot, janë me të vërtetë të verbër dhe mbeten në mëkate të tyre (Jn. 9:41). Të tjerët kanë dritën e jetës dhe mund ta shohin dhe ta njohin Birin e Perëndisë, sepse **“ti e ke parë; është pikërisht ai që po të flet” (Jn. 9:37).**

I verbuar plotësisht, nga sytë e shpirtit, tek ty vij, o Krishti im, pors i verbri në Ungjill dhe i penduar thërras me lot: Ndritmë në të errët, o dritë e qiellit! (Shkurtorja).